



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1041/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin Sali Zeneli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1041/2021, paraqitur nga Sali Zeneli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 1501E/02R, 1501E/06R, 1503E/02D, 1512E/03D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Sali Zeneli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendon se në Vendvotimin 1501E/02R vërehen përmirësime nga numri i votave 2 me numrin, në vendvotimin 1503E/02D ka mospërputhje të votave ashtu që subjekti ka gjithsej 43 vota derisa kandidatët kanë gjithsej 44 vota, në vendvotimin VV 1501E/06R kanë votuar dhjetë familjar të tij kurse ka vetëm gjashtë vota. Andaj ka kërkuar që të rinumërohen Qendrat e Votimit VV 1501E/02R, VV 1501E/06R, VV 1503E/02D, VV 1512E/03D. Në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Sali Zeneli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Qendrat e Votimit 1501E-02R, 1501E-06R, 1503E/02D, 1512E/03D është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tij nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të theksuara në apel, andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të bazuara pasi që nuk janë të mbështetura në ndonjë provë.

Kështu që Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1041/2021 më datën 07.11.2021



kryesues i Panelit
Burim Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.